



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2022:112630

Datë: 02.08.2024

Numri i dokumentit: 06013756

2022:112631

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Izet Shabani, E. Xh-J, B.A, E.H.- J, B. A, E.V, S.B, A.M dhe R.B nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson av. S.R nga Ferizaj kundër të paditurës T.K.Sh.A me seli në Prishtinë, me NUI ..., të cilin e përfaqëson zyrtari ligjor R.B nga Gjilani, me objekt kontesti shpërblimi jubilar, kompensimi i shujtave dhe shtesave për përvojën në punë, vlera e kontestit 39,251.52€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, më dt. 02.08.2024 ka marrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve I.Sh, E. Xh. J, B. A, B.A, E.V, S.B, dhe R.B kundër të paditurës T.K.Sh.A me seli në Prishtinë, ashtu që DETYROHET e paditura T.K.me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, kompensimin e shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit dhe shpërblimin jubilar përvojë pune, t'ua kompensoj paditësve:

-I.Sh, me numër personal .... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 2217,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 739 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 1,037.87€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 1441.48€, apo në shumë të përgjithshme prej 4696,35€ (katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e pesë cent),

-B.A me numër personal ..... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej

1938,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 646 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 1233,10€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 1208,92€, apo në shumë të përgjithshme prej 4380,02€ (katër mijë e treqind e tetëdhjetë euro e dy cent).

-E. H. J me numër personal ... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 2169,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 723 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 1155,74€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 1284,16€, apo në shumë të përgjithshme prej 4608,9€ (katër mijë e gjashtëqind e tetë euro e nëntëdhjetë cent).

-B.A me numër personal ... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 2070,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 690 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 963,12€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumë prej 1284,16€, apo në shumë të përgjithshme prej 4317,28€ (katërmijë e treqind e shtatëmbëdhjetë euro e njëzetë e tetë cent).

-E.V me numër personal ... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 2349,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 783 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 731,97€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, apo në shumë të përgjithshme prej 3080.97€ (tremijë e tetëdhjetë euro e nëntëdhjetë e shtatë cent), kurse kërkesa e paditësit E.V lidhur me shpërblimin jubilar në shumë prej 642,08€, refuzohet si e pabazuar.

-S.B me numër personal ... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 2403,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 801 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 870,42€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumë prej

1208,92€, apo në shumë të përgjithshme prej 4,482.34€ (katërmijë e katërqind e tetëdhjetë e dy euro e tridhjetë e katër cent).

-R.B me numër personal ..... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës: në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 2178,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 726 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 1117,95€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, apo në shumë të përgjithshme prej 3,295.95€ (tremijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e pesë cent), ndërsa kërkesa lidhur me shpërblimin jubilar në shumën prej 980,66€, refuzohet si e pabazuar.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve A.M. me numër personal .... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës me të cilën ka kërkuar në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, shuma prej 2376,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 792 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, shuma prej 847,55€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 1284,16€, apo në shumë të përgjithshme prej 4507,71€ dhe E.Xh.J. me numër personal .... të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës me të cilën ka kërkuar në emër të kompensimit të shujtave ditore duke llogaritur 3 euro për ditë pune, i takon shuma prej 1800,00€, duke pas parasysh se paditësi ka qenë prezent në punë për 600 ditë, në emër të kompensimit të shtesave për përvojë pune me 0.5% për çdo vit, paditësit i takon shuma prej 977,78€, duke u bazuar në pagën mujore të paditësit, në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 1481.48€, apo në shumë të përgjithshme prej 4259,26€.

III. DETYROHET e paditura T.K.me seli në Prishtinë që në emër të kompensimit të shpenzimeve procedurale paditësve I.Sh, E. Xh. -J, B.A, B.A, E.V, S.B, dhe R. B të ua paguajë solidarisht shumën totale prej 3,002€ (tremijë e dy euro), në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

### Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. S.R nga Ferizaj kanë parashtruar padi më dt. 02.06.2022 pranë kësaj gjykate, kundër të paditurës, me objekt kontesti shpërblimi jubilar, kompensimi i shujtave, shtesave për përvojën në punë, vlera e kontestit 39,251.52€. Në padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka theksuar se: mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar në këtë gjykatë lidhur me kompensimin e shujtave, kompensimin e shtesave për përvojën e punës si dhe shpërblimin e pagave jubilarë për secilin prej paditësve veç e veç, përgjigjen në padi nga e paditura e kundërshtojmë meqë e njëjta përgjigje në padi përveç kundërshtimeve të cilat i paraqet si çështje fillestare e pastaj thirret në parashkrim e në mungesë të buxhetit në thelb konstaton se marrëveshja kolektive e vitit 2019 ka qenë në fuqi dhe mbetet në fuqi në bazë të së cilës e paditura ka qenë e obliguar që ti përmbushë detyrimet e saj për sa i përket beneficioneve të cilat rrjedhin nga kjo marrëdhënie pune, andaj duke marrë parasysh se paditësit fillimisht kishin ushtruar kërkesa edhe përmes sindikatës për kompensimin e këtyre beneficioneve dhe kërkesa përmes avokatit lidhur me kompensimin apo marrëveshjen për kompensimin e këtyre beneficioneve e njëjta përveçse nuk i është përgjigjur me një email të përgjithshëm i ka refuzuar këto kërkesa dhe më tej të njëjtit kanë parashtruar padi andaj përgjigja në padi e të paditurës është e pakuptimte dhe e pa bazuar kur thekson se paditë nuk kane vulë apo se padia është e pasafatshme. Meqenëse pretendimet e të paditurës kanë të bëjnë edhe për sa i përket mundësive buxhetore më duhet të ritheksoj se marrëveshja kolektive lidhur me këtë kategori nuk ka parashikuar një mënyrë të tillë të performancës por në përpikëri ka theksuar se të njëjtit gëzojnë beneficionet në përputhje me këtë marrëveshje dhe atë beneficionet e përshkruara në këtë marrëveshje janë beneficionet për shujtat prej 3 euro, beneficioni për kompensimet shtesë dhe shpërblimet jubilarë. Për më tepër kërkesëpadia e paditësve mbështetet në marrëveshjen kolektive të punës në T. e Kosovës me numër 01-.../19, të cilën marrëveshje kolektive e kanë lidhur T.K. me Federatën Sindikale të PTK-së, e cila aplikohet nga data 01.06.2019 në bazë të nenit 4 kjo marrëveshje është lidhur për 3 vite duke filluar nga data 01.06.2019-31.05.2022, për më tej neni 2 ka paraparë që nëse palët nuk lidhin marrëveshje prej kjo marrëveshje do të vlej edhe në të ardhmen, përveç asaj në bazë të nenit 44 të rregullores parashihen beneficionet tjera për të cilat e paditura ka marrë për obligim që ti mbuloj. Gjatë këtij shqyrtimi është vërtetuar se paditësit kanë qenë të punësuar tek e paditura, si dhe të njëjtit në bazë të kontratës kolektive të dt. 31.05.2019, kanë pasur të drejtë në

shtesën për përvojën e punës prej 0.5% në vit për pagë jubilarë në bazë të nenit 38 të kontratës kolektive si dhe në bazë të nenit 44 pika 3 kompensimin e shujtave në vlerë prej 3 euro, gjithashtu gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar se e paditura nuk ka përmbushur detyrimet e saj në përputhje me këtë kontratë, e as në përputhje me ligjin e punës neni 55 që ti kompensoj paditësit lidhur me shtesat në punë, është vërtetuar gjatë këtij shqyrtimi se paditësit i janë drejtuar me kërkesë të paditurës për realizimin e këtyre të drejtave e që një e drejtë e tillë nuk ju ka përmbushur nga e paditura, në këtë shqyrtim është nxjerrë edhe ekspertiza e ekspertit A.K e cila ekspertizë është bazuar edhe në materialet e nxjerra nga departamenti i burimeve njerëzore të vet e paditura, e me të cilën ekspertizë është përcaktuar saktë se paditësve ju mungojnë pagesat për përvojën e punës, pagën jubilarë, shujtat ditore, dhe atë në vlera të ndryshme ku për paditësit është përcaktuar shuma totale në fq 12 të kësaj ekspertize, andaj duke marr parasysh gjitha këto i propozojë gjykatës që padinë e paditësve ta aprovoje dhe që të detyroje të paditurën me baze të parashtrësës së dorëzuar të kompensojë paditësit veç e veç si dhe të detyrojë të paditurën të kompensoje edhe shpenzimet e procedurës në përputhje me parashtrësën e dorëzuar për padi 624 euro, për dy seanca 1622.4 euro, për ekspertizë 250 euro si dhe për takse 121 euro.

Përmes përgjigjes në padi të dt. 30.05.2023, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, i autorizuari i të paditurës ka theksuar se: kërkesëpadinë e paditësve e kontestojmë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, lidhur me këtë çështje e paditura ka parashtruar një përgjigje në padi lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e cila shkresë gjendet në shkresat e kësaj lende dhe qëndrojmë në tërësi pranë asaj që kemi argumentuar në atë përgjigje në padi si për nga themelësia e kërkesëpadisë së paditësve ashtu edhe për nga afatshmeria e padisë si dhe shkeljet tjera procedurale të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës numër 03/L-2012, përkatësisht mosrespektim të nenit 78 dhe 79 të këtij ligji. Ka shtuar se, marrëdhënia e punës rregullohet me ligjin e punës 03/L-2012, neni 90 i këtij ligji në mënyrë të kjarë ben fjale për dialogun social dhe specifikisht për marrëveshjet kolektive. Kjo dispozite ligjore e ndare në 10 paragrafë në mënyrë të sakte tregon se si duhet të lidhet marrëveshja kolektive, përderisa neni 8 i kësaj dispozite ligjore në mënyrë shprehimore thuhet "Marrëveshja kolektive regjistrohet në ministri në pajtim me kushtet dhe kriteret e paracaktuar me aktin në ligjor.", nga kopja e kontratës kolektive numër 01-.../2019 e datës 31.05.2019 të cilën marrëveshje e posedojnë palët ndërgjyqese shihet se e njëjta është e nënshkruar nga kryetari i FSP TK dhe kryeshefi ekzekutiv i TK-se të asaj kohe dhe është regjistruar në librin e protokollit të TK-se. Por ajo marrëveshje kolektive asnjëherë nuk është regjistruar në Ministrinë e Punës

dhe Mirëqenies Sociale te asaj kohe ashtu siç e parasheh dispozita ligjore përkatësisht neni 90 par.8 i ligjit të punës si dhe udhëzimi administrativ numër 12/2011 për regjistrimin e marrëveshjeve kolektive. Kjo do të thotë se kjo marrëveshje mbi bazën e se cilës paditësit kanë paraqitur kërkesat e tyre asnjëherë nuk është formalizuar ashtu siç e parashohin dispozitat ligjore e që do të thotë se ky dokument, kontrata kolektive numër 01-327/2019 e datës 31.05.2019 e lidhur në mes të FSP TK dhe ish menaxhmentit të TK-se se asaj kohe është pa fuqi juridike dhe e njëjta nuk mund të prodhojë efekte juridike përveçse palët nëse dëshirojnë që vullnetarisht ta implementojnë atë. Po ashtu ka deklaruar se asnjë punëtori të T. nuk i është paguar vullnetarisht asnjë kërkesë e llojit të njëjtit siç e kanë kërkuar tani paditësit me padi. Nga dispozitat ligjore të ligjit të punës shihet kjo se marrëveshjet kolektive janë rigorozisht formale dhe në mungesë të respektimit të formës ligjore të njëjtat nuk mund të prodhojnë efekte juridike. Sa i përket asaj nga deklarimi i përfaqësuesit të paditësve se në bazë të nenit 2 të marrëveshjes e njëjta vazhdon mund të themi se edhe kjo dispozite është tërësisht në kundërshtim me dispozitat e ligjit të punës sepse i njëjti ligj në mënyrë shprehimore deklaroi se marrëveshjet kolektive lidhen për një afat 3 vjeçar. Po ashtu e ka njoftuar gjykatën se siç shihet nga padia e paditësve thuhet se të njëjtit janë të gjithë punëtor të Telekomit të Kosovës, e njëjta nuk qëndron për faktin se paditësi E.Xh-J dhe paditësi A.M kanë lidhur një marrëveshje me Telekomin e Kosovës dhe kanë pranuar pakon vullnetare ku në nenin 6 të asaj marrëveshje thuhet se pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje i punësuar garanton që nuk ka ndonjë pretendim apo kërkesë të çfarëdo natyre nga marrëdhënia e punës të Telekomit të Kosovës Sh.a dhe nuk do të përdorë asnjë lloj mjete juridik për asnjë lloj pretendimi në organet kompetente kundrejt Telekomit të Kosovës sh.a. Telekomit të Kosovës, për të sqaruar dhe argumentuar me tutje pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësve nga këndvështrimi i të paditurës janë se paku, 3 elemente kryesore të cilat kërkesëpadinë e paditësve e bëjnë të pa themeltë, e para nëse shohim me vëmendje neni 54 p. 2 të kontratës kolektive mbi bazën e se cilës thirren paditësit në mënyrë shprehimore në ato dispozite të kontratës thuhet se: Zbatimi i marrëveshjes TK sindikatë për pagat dhe ndarjen e bonusit me numër 663/01, dt. 15.02.2005, dhe aneksi i kësaj marrëveshje të vitit 2010 si dhe sigurimi shëndetësor i punëtorëve garantohet nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje për periudhën e vlefshmërisë së kontratës në fjale. Nga interpretimi i kësaj dispozite shihet se marrëveshja TK – sindikatë për pagat dhe bonuset asnjëherë nuk është shfuqizuar nga palët nënshkruese, dhe e njëjta vazhdon të jete në fuqi, ndërsa sipas asaj marrëveshje të gjitha benefitet që janë bonuse dhe shujtat ditore dhe shtesat e tjera që nuk e përbejnë pagën baze të cilat deri në hyrjen në fuqi të asaj marrëveshje janë paguar veçmas nga paga e punonjësve tani me hyrjen në fuqi të asaj marrëveshje të gjitha këto shtesa janë të inkorporuar në pagën baze të secili punonjës. Argumenti i dytë ka të bëjë me

paditësit E. Xh J... dhe A.M.... te njëjtit ne mënyra vullnetare kane ndërpre marrëdhënien e punës me Telekomin e Kosovës bazuar ne dispozitat e ligjit te punës nr 03/L-212 neni 68 i Ligjit, dhe ne nenin 6 te kontratës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës thuhet se: Pas nënshkrimit te kësaj marrëveshje, i punësuari garanton qe nuk ka ndonjë pretendim apo kërkesë për çfarëdo natyre nga marrëdhënia e punës ndaj Telekomit te Kosovës SH.A, dhe se nuk do te përdore asnjë mjet juridik. Dhe elementi i 3 i cili ne tërësi e bën te pathemelte kërkesëpadinë e paditësve është se baza juridike mbi te cilën paditësit i mbështesin kërkesat e tyre, respektivisht kontrata kolektive me numër 01-3207/19, dt 31.05.2019 nuk ka fuqi juridike dhe se e njëjta nuk mund te prodhoje efekte juridike ne mes palëve nënshkruese përveç se ne rast se palët vullnetarisht dëshirojnë ta implementojne atë për faktin se ashtu siç kemi deklaruar ne këtë gjykatë ajo marrëveshje kolektive asnjëherë nuk është regjistruar ne Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale si institucion kompetent për regjistrimin e marrëveshjeve kolektive, ashtu siç e parasheh dispozita ligjore neni 19 p.8 i ligjit te punës dhe udhëzimi administrativ 12/2011 andaj propozojmë gjykatës qe këtë marrëveshje ta konsideroje nule. Gjithashtu i kundërshtojë shpenzimet procedurale si dhe i propozojë gjykatës qe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoi ne tërësi si te pabazuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto prova materiale: Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-.../2011 e datës 20.10.2011 për B. A, Kontrate pune me numër 01-...-05 e datës 20.10.2005 për B.A, Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-...2015 e datës 02.09.2015 për B.A, Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-.../2012 e datës 27.03.2012 për R.B, Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-.../2015 e datës 02.09.2015 për R.B, Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-.../2015 e datës 02.09.2015 për I.Sh, Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-.../2015 e datës 02.09.2015 për B.A, Kontrate pune për kohe te pacaktuar me numër 01-.../2015 e datës 02.09.2015 për E.J, Lista e orëve te punës sipas ditëve nga 31.05.2019-01.04.2022, e pa vulosur dhe e pa nënshkruar,Lista e pagesës për paditësin E.J e datës 06.04.2022, I.Sh e datës 31.03.2022, Lista e orëve te punës për paditësin B.A, e pa vulosur dhe e pa nënshkruar dhe ekspertiza financiare e ekspertit gjyqësor A.K nga Ferizaj e dt. 15.04.2024.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr.01-.../2011, datë 20.10.2011, kontratës së punës nr.01-...-05, datë 20.10.2005, kontratës së punës nr. 01-...2015, e dt. 02.09.2015, e lidhur

mes paditësit B.A dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e teknikut të elektros, në afat të pacaktuar.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-...2012, datë 27.03.2012, 01-.../2015, dt. 02.09.2015 dhe nr. 01-.../2015, dt. 02.02.2015, e lidhur mes paditësit R.B dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e kordinatorit regional (Fer.Gjil.) për sist el. Energjet. dhe inxhinier specialist, në afat të pacaktuar.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-.../2015, datë 02.09.2015 e lidhur mes paditësit I.Sh dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Kryeteknikut në Departamentin Teknik, në afat të pacaktuar.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-...2015, datë 02.09.2015 dhe nr. 01-.../2015, e dt. 02.09.2015 e lidhur mes paditësit E.J dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Teknikut Specialist në Departamentin Teknik, në afat të pacaktuar.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-.../2015, datë 02.09.2015 e lidhur mes paditësit B.A dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Teknikut Specialist në Departamentin Teknik, në afat të pacaktuar.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-...9/23, i dt. 22.05.2023, vërtetohet se paditësi I.Sh ka qenë në marrëdhënie pune në ish PTT nga 1/... deri 4/1... dhe nga ... deri 12/9... dhe është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 08....1999 dhe vazhdon me kontratë pune për kohë të pacaktuar. I punësuar i lartpërmendur është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Kryeteknik nga dt. 01.09.2015 dhe nga dt. 15.5.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 817,00€.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-...5/23, i dt. 24.05.2023, vërtetohet se paditësi E. J ka qenë në marrëdhënie pune në ish PTT nga 1/... deri 13.09.1990 dhe në marrëdhënie pune me Telekomini e Kosovës nga dt. 08.12.1999 deri 31.05.2022. Ish i punësuar i lartpërmendur ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Kryeteknik me kontratë pune për kohë të pacaktuar nga dt. 01.09.2015-31.05.2022 dhe nga dt. 15.5.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 817,00€.

Me leximin e Marrëveshjes për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. 01-2272/22, i dt. 27.05.2022, vërtetohet se paditësi E.J dhe e paditura më dt. 27.05.2022 kanë lidhur marrëveshje



për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me marrëveshje më dt. 31.05.2022 nën kushtet e cekura në këtë marrëveshje.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-1815/23, i dt. 22.05.2023, vërtetohet se paditësi B.A ka qenë në marrëdhënie pune në ish PTT nga dt. 29.03.1980 deri 13.09.1990 është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 08.12.1999 deri më dt. e pensionimit 27.11.2023. I punësuari i lartpërmendur është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Teknik i elektros nga dt. 01.09.2015-27.11.2023 dhe nga dt. 15.05.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 681,00€.

Me leximin e Vendimit nr. 05-.../99, i dt. 08.12.1999, ka vërtetuar se paditësi E.J përkohësisht caktohet në vendin e punës Teknik specialist në mirëmbajtje në PTK-njësia punonjëse në Ferizaj.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-.../23, i dt. 22.05.2023, vërtetohet se paditësi B.A.. ka qenë në marrëdhënie pune në ish PTT nga dt. 15.12.1986-15.06.1988 dhe është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 02.12.1999 dhe vazhdon me kontratë pune për kohë të pacaktuar. I punësuari i lartpërmendur është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Teknik specialist nga dt. 01.09.2015 dhe nga dt. 15.05.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 725,00€.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-.../2015, datë 02.09.2015 e lidhur mes paditësit B.A.. dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Teknikut specialist në Departamentin Teknik, në afat të pacaktuar.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-...23, i dt. 22.05.2023, vërtetohet se paditësi E.V.. është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 15.02.2005. I punësuari i lartpërmendur është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Anëtar i ekipit për përkrahje në terren nga dt. 01.09.2015 dhe nga dt. 15.05.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 725,00€.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-.../2015, datë 02.09.2015 e lidhur mes paditësit E.V..... dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Anëtar i ekipit për përkrahje në terren në Departamentin Teknik, në afat të pacaktuar.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-.../23, i dt. 22.05.2023, vërtetohet se paditësi S.B..... është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 02.08.1999. I punësuari i lartpërmendur është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Udhëheqës i pikave të shitjes dhe nga dt. 15.05.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 681,00€.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-.../2015, datë 22.12.2015 e lidhur mes paditësit S.B..... dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Udhëheqësit të pikave të shitjes, në afat të pacaktuar.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05-1.../23, i dt. 22.05.2023, vërtetohet se paditësi A.M.... është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 22.02.2000 deri më dt. 31.05.2022. Ish i punësuar i lartpërmendur ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Anëtar i ekipit për përkrahje në terren nga dt. 01.09.2015-31.05.2020 dhe nga dt. 15.05.2020 me të ardhura personale mujore bruto prej 725,00€.

Me leximin e kontratës së punës për kohë të pacaktuar nr. 01-.../2015, datë 02.09.2015 e lidhur mes paditësit A.M..... dhe të paditurës, rezulton se paditësi është punësuar te e paditura në cilësinë e Anëtarit të ekipit për përkrahje në terren, në afat të pacaktuar.

Me leximin e Marrëveshjes për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr. 01-.../22, i dt. 27.05.2022, vërtetohet se paditësi A.M..... dhe e paditura më dt. 27.05.2022 kanë lidhur marrëveshje për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me marrëveshje më dt. 31.05.2022 nën kushtet e cekura në këtë marrëveshje.

Me leximin e Vërtetimit nr. 05.../23, i dt. 24.05.2023, vërtetohet se paditësi R.B... është në marrëdhënie pune tek e paditura nga dt. 15.02.2005. I punësuar i lartpërmendur është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Udhëheqës për furnizim me energji elektrike dhe klimatizim nga dt. 01.09.2015 me të ardhura personale mujore bruto prej 1121,00€.

Me leximin e ekspertizës financiare të ekspertit financiar A.K... nga Ferizaj e dt. 15.04.2024, rezulton konstatimi dhe mendimi pas analizës së detajuar të të gjitha dokumenteve në dispozicion dhe përlllogaritjeve përkatëse lidhur me lëndën gjyqësore, kjo ekspertizë konstaton përmbledhjen e llogaritjes së 3 llojeve të pagesave shtesë për 9 paditësit sipas tabelës finale të paraqitur në fq. 12 të ekspertizës.

#### Vlerësimi i provave dhe zbatimi i të drejtës materiale

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar. Bazuar në nenin 44 të Marrëveshjes Kolektive të Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01- ....19 e dt. 31.05.2019, në bazë të cilës paditësve për përvojë të punës ju takon vlera e pagës bazë varësisht nga përvoja.

Po ashtu me Rregulloren për marrëdhënie pune të Telekomit të Kosovës nr. 01- .../19 e dt. 29.11.2019, me dispozitën e nenit 38 par. 7 parashikohet e drejta në shtesën për përvojën e punës prej 0.5 % të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës dhe për shujta ditore, si dhe me dispozitën e nenit të njëjtit 38 par. 8 parashikohet paga jubilarë për 10 vite të përvojës së punës në lartësinë e një page të fundit të punëtorit. Gjykata gjeti se Marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01-.../19 e dt. 31.05.2019, dhe Rregullorja për marrëdhënie pune te Telekomit të Kosovës nr. 01.../19 e dt. 29.11.2019, janë të zbatueshme në rastin konkret.

Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve por edhe është vërtetuar në mënyrë të plotë se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, vitin jubilar e kanë arritur më datë brenda kohës së vlefshmërisë së kontratës kolektive të lartcekur, padinë në gjykatë e kanë ushtruar më datë 02.06.2022, po ashtu ditët e pranisë në punë dhe shuma prej 3.00 € në ditë dhe shuma në emër të kompensimit për përvojën e punës janë vërtetuar me ekspertizën e ekspertit përkatës, ndaj të cilës nuk kanë pasur vërejtje palët ndërgjyqëse, në rastin konkret kontestuese ka qenë baza juridike e padisë. Me nenin 90 parag. 1 të Ligjit të Punës 03/L-212, të datës 01.11.2010, ku përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve, ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve ". Në nenin 44 të Marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomin e Kosovës nr. 01- 3.../19 e dt. 31.05.2019, ku thuhet se punonjësve u takon kompensimi i shtesave për përvojë pune 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Pretendimet e të paditurës lidhur me atë se paditësve nuk ju takon shpërblimi jubilar sepse në kohën e arritjes së vitit jubilar, nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja kolektive e punës në Telekomin e Kosovës, e dt.31.05.2019, nuk qëndrojnë për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës në kohën e arritjes së vitit jubilar mbështetur në përvojën e punës së paditësve të përshkruar në fq. 7 të ekspertizës së ekspertit financiar në të cilën gjykata është mbështetur gjatë dhënies së vendimit, ka qenë në fuqi Marrëveshja kolektive e punës në Telekomin e Kosovës, e dt.31.05.2019, që nënkupton se padia e paditësve ka bazë juridike.

Për sa i përket zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata vlerëson se është përfundim i drejtë aprovimi i pjesëshëm i kërkesëpadisë së paditësve sepse e paditura duke mos e kryer detyrimin e saj, ju ka mbetur borxh paditësve për pagesën e shpërblimit jubilar, shujtave ditore, si dhe e drejta për përvojën e punës prej 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës; andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor. Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret është obligim i të paditurës të zbatojnë marrëveshjen e brendshme të saj, pasi që e njëjta

Marrëveshja Kolektive e Punës në Telekomini e Kosovës nr. 01-.../19 e datës 31.05.2019 vet e ka nënshkruar me Sindikatën e punëtorëve, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura ti përmbushë kompensimin e shujtave ditore, si dhe e drejta për përvojën e punës prej 0.5% të pagës bazë për çdo vit të plotë të përvojës së punës. Marrëveshja Kolektive e punës në Telekomini e Kosovës e datës 31.05.2019, ka qenë në fuqi sepse sipas nenit 4 të saj, marrëveshja ka kohëzgjatje prej 3 vjetësh dhe prodhon efekt nga data 01.06.2019 deri më 31.05.2022 (lidhur me këtë shih në këtë drejtim edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme e Kosovës në Prishtinë Rev.nr.512/2023, datë 20.02.2024). Kërkesëpadia e paditësve është pikërisht brenda kësaj periudhe kohore.

Lidhur me lartësinë e shumave të kërkesave të aprovuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata u mbështet ekspertizën gjyqësore financiare të ekspertit A.K.... nga Ferizaj, të administruar si provë në këtë shqyrtim gjyqësor, të cilës gjykata ja fali në tërësi besimin sepse kjo ekspertizë përmban të dhëna të mjaftueshme, të sakta dhe të plota, pasi që e njëjta ka pasqyruar në tërësi gjendjen faktike, e njëjta është e hartuar dhe mbështetur në arritjet e fundit shkencore pala e paditur përkundër kontestimit verbal dhe përkundër vërejtjeve nuk ka dhënë ndonjë propozim të ri për prova apo për plotësim të procedurës së provave, e po ashtu sipas konstatimit të gjykatës, e njëjta i përmban të gjitha elementet e nevojshme që duhet të ketë një ekspertizë, e njëjta është dhënë mbi bazën e njohurive profesionale të ekspertit të cilën gjykata e vlerësoi si të drejtë.

Ndërsa nuk ka parashkrim të kërkesëpadiës ashtu siç pretendon e paditura për pjesën e aprovuar të kërkesëpadiës së paditësve në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse kërkesëpadia është parashtruar brenda afatit 3 vjeçar nga koha e arritjes së jubileut të punësimit të e paditura, ndërsa gjykata për të arritur në këtë përfundim të drejtë dhe të saktë është mbështetur në kontratat e punës së paditësve të cilat gjinden në shkresat e lëndës lidhur me ekspertizën financiare të ekspertit A.K gjegjësisht në fq. 7 të saj ku është paraqitur tabela përmbledhëse e paditësve (të dhënat për përvojën e punës, pagat dhe ditët e punës).

Objekt i shqyrtimit ishin edhe pretendimet e palës së paditur se e paditura është duke operuar me humbje dhe vështirësi financiare, por gjykata gjeti se pretendimet e tilla nuk janë shkaqe të arsyeshme, të justifikueshme dhe të ligjshme për të vendosur ndryshe, ndaj dhe gjykata pretendimet e tilla i refuzoi si të pabazuara. E paditura pretendon se nuk ka buxhet për këtë lloj kompensimi sepse nuk ka mjete financiare për këtë qëllim dhe të njëjtat i paguan sipas performancës pozitive financiare ku thirret në pasqyrat financiare për periudhën që ka përfunduar

më 31.12.2019 dhe raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të paditurës për vitin 2020, të administruara si prova në këtë shqyrtim, prandaj kjo gjykatë vlerëson se është çështje brendshme e të paditurës dhe nuk ka ndikim në vendimin e gjykatës. Pretendimet e të paditurës se marrëveshja kolektive nr. 01-3207/19 e dt. 31.05.2019 nuk është në fuqi dhe se e njëjta nuk mund të prodhojë efekte juridike në mes të palëve nënshkruese përveç se në rast se palët vullnetarisht dëshirojnë ta implementojnë atë për faktin se ajo marrëveshje asnjëherë nuk është regjistruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies sociale, mbetet pretendim verbal dhe deklarativ, i pambështetur në fakte dhe prova, prandaj si i tillë nuk ka ndikim në vendosje ndryshe të kontestit.

Arsyet për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve E. Xh.- Jashari dhe A.M...

Me leximin e referatit të padisë së paditësve thuhet se të njëjtit janë të gjithë punëtor të Telekomit të Kosovës, e njëjta nuk qëndron për faktin se paditësi E. Xh.- J dhe paditësi A.M.. kane lidhur një marrëveshje me Telekomin e Kosovës dhe kanë pranuar pakon vullnetare ku në nenin 6 të asaj marrëveshje thuhet se pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje i punësuar i garanton që nuk ka ndonjë pretendim apo kërkesë të çfarëdo natyre nga marrëdhënia e punës të Telekomit të Kosovës Sh.a dhe nuk do të përdorë asnjë lloj mjeti juridik për asnjë lloj pretendimi në organet kompetente kundrejt Telekomit të Kosovës Sh.A. Andaj meqenëse lidhja e kontratës në fjalë ishte në pajtim me dispozitat ligjore, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e këtyre dy paditësve është e pabazuar. Ndërsa në ndërlidhje me të lartcekurat, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka hequr dorë nga pretendimet pasurore që ka dhe do të kishte në të ardhmen kundër të paditurës. Në shkresat e lëndës mungon ndonjë provë materiale e cila do të vërtetonte faktin se paditësit kanë qenë në lajthim, presion, mashtrim, kërcënim apo ndonjë formë tjetër të dhunës apo presionit psikik me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, andaj mbi këtë bazë vijmë deri te përfundimi i drejtë dhe i ligjshëm se këto marrëveshje janë të vlefshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Arsyet për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve E.V dhe S.B... lidhur me shpërblimin jubilar

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve E..V lidhur me shpërblimin jubilar në shumën prej 642,08€ dhe S.B lidhur me shpërblimin jubilar në shumën prej 980,66€, duhet refuzohet si e pabazuar sepse në bazë të ekspertizës gjyqësore financiare e cila është punuar dhe ndërtuar në bazë të dhënave të marrura nga shërbimi i burimeve njerëzore i Telekomit të Kosovës, rezulton që përvoja e punës e të dy këtyre dy paditësve fillon nga dt. 15.02.2005 (shih fq. 7 të ekspertizës

financiare), ndërkaq padia e paditësve është paraqitur në gjykatë më dt. 02.06.2022, rrjedhimisht jubileun e punësimit e kanë pasur më dt. 15.02.2015, kurse padinë e kanë parashtruar pas diku 7 viteve, që nënkupton se padia e paditësve në këtë pjesë është e parashkruar gjë që pretendimin e të paditurës e bën të bazuar në këtë aspekt, por kërkesëpadia e këtyre dy paditësve nuk ka bazë juridike edhe për faktin se kontrata kolektive e punës në Telekomin e Kosovës me numër 01-3207/19, të cilën marrëveshje kolektive e kanë lidhur T.K.me Federatën Sindikale të PTK-së, aplikohet nga data 01.06.2019 në bazë të nenit 4 kjo marrëveshje është lidhur për 3 vite duke filluar nga data 01.06.2019-31.05.2022. Andaj me të drejtë rrjedhë përfundimi se kërkesëpadia e këtyre dy paditësve lidhur me shpërblimin jubilar është e pabazuar dhe si e tillë refuzohet nga ana e gjykatës.

Gjykata i pati parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, por disa prej pretendimeve që i cilësoi si irelevante nuk i arsyetoi veç e veç, për shkak se nuk çuan peshë në vendosjen ndryshe të kontestit. Ndërsa Neni 6 i KEDNJ kërkon që gjykatat vendase të japin arsye mbi vendimet e tyre si në çështjet civile, ashtu edhe në ato penale. Gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pyetje, por nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, gjykata atëherë duhet që specifikisht t'i trajtojë ato në gjykimin e saj, qëndrim i mbajtur në rastin Van de Hurk kundër Holandës, aplikacioni nr. 16034/90, të dt. 19.04.1994, par. 61. Ndërkaq sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata vendosi konform nenit 452.1 të LPK-së lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TOAK, vlera e kontesteve mbi 10,000€, lidhur me shpenzimet procedurale, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësve të jau kompensoj shpenzimet procedurale në lartësi prej 3,002€, edhe atë si në vijim: për taksën për padi 100,00€, për hartimin e padisë nga avokati shumë prej 624,00€, për dy seanca gjyqësore të përfaqësuara nga avokati shumë prej 811.2€ secila, në total shumë prej 1622.4€ si dhe për një seancë të shtyrë pa fajin e paditësve shumë prej 405.6€.

Andaj, bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.2022:112631, datë 02.08.2024

Numri i lëndës: 2022:112630  
Datë: 02.08.2024  
Numri i dokumentit: 06013756

Gjyqtari

Armend Ahmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të tij, në Gjykatën e Apelit e Kosovës, e përmes të kësaj gjykate.